

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“BPM” - sh.p.k

Sot ne Tirane ,date 01.08.2022 u krijua shoqeria “ BPM” sh.p.k.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij Akt Themelimi ne ortaket:

- 1. Z.Artur Kurti**, lindur me 04.03.1975, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, i identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr.personal H50304061W, **ne cilesine e Ortakut Themelues**

VendosI te krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“BPM”sh.p.k** me akt themelimi si vijon:

EMERTIMI

NENI 1

1.1 Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur **“BPM” sh.p.k.**

1.2 Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

2.1 Shoqeria e ka seline qendrore **ne Adresen:Lagjia ALI DEMI , Rruga “Zonja Curre” , Pallati Boga 1, Apartamenti nr 18 , Tirane.** dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

2.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale si brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

- 2. Shoqeria “BPM”sh.p.k.do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:**
- Gjetjen e tregjeve ndërkombëtare ku kompanitë Shqiptare mund të tregtojnë



produkte dhe makineri /pjesë kembimi ,produkte ushqimore,etj .

- Shërbime IT ,telekomunikacion .lenden e pare per produktet elektronike,elektrike,hidraulike etj.

- Shërbime ndërmjetesimi midis kompanive shqiptare dhe atyre te huaja te profielve te ndryshme si shitje blereje makinerish industriale,dhe pjeset e kembimit te tyre gjetjen e lendeve te para per prodhime te ndryshe bujqesore,ushqimore,perpunimin e mineraleve,te prodhimit te energjise se rinovueshme ,hidrokarbureve ,projektim dhe zbatim projektesh ne fushen e ndertimit dhe arkitekture.Krijim te software,marketingut ,hardware shitjeve te shërbimeve te IT dhe telekomunikacionit e komunikacioneve elektronike.

- Tregëti me shumice e pakice e artikujve industriale,bujqesore,ushqimore,materiale textile,makinerive industriale pjesëve te kembimit ,te bicikletave elektrike/ monopatinat makina dhe mjete dhe automjete te tjera elektronike si dhe pjesëve te tyre te kembimit etj.Importe dhe eksporte te ndryshme.

- Ndermjetesimi i konferencave,pjesëmarrja ne tendera te ndryshem ,pregatitja dhe zhvillimi i konferencave,seminareve ,menaxhimi i kurseve profesionale te ndryshme ,konsulenca te ndryshme etj.

- Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i veprave civile dhe industriale, sistemeve elektrike dhe hidraulike, impiante te cdo lloji , ndertimi dhe krijimi e menaxhimi i fabrikave,linjave te prodhimit ,shitja dhe blerja e pasurive te patundshme

- Gjetjen e tregjeve ndërkombetare per prodhimet vendase dhe promovimi i kompanive shqiptare si dhe prezantimi dhe pjesëmarrja e tyre ne panairë,seminare,konferencave etj.

- Qiradhenien e automjeteve.mjeteve detare te ndryshme te imatrikuluara jo me shume se 12 milje per perdorim privat ose per publicitet ose per te perfaqesuar qiradhenien e aeromobileve te mongolfierave detare a[po ajrore te ndryshme si dhe projektimet e disenjimeve modeleve te tyre per llogari te paleve te treta.

- Tregtimin me shumice te pijeve alkolike dhe analkolike te llojeve dhe markave te ndryshme brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE NENI 4

4.1 Shoqeria “BPM” sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.

KAPITALI I SHOQERISE



NENI 5

5.1. Kapitali i shoqerise "BPM" sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 1,000 leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

5.1. Ortaku themelues **Artur Kurti**: lindur ne Tirane, Shqipëri ne daten 04/03/1975 ,identifikuar me karte identiteti me NR: H50304061W banues ne adresen Lagjia ALI DEMI,Rruga Zonja Curre Pallati BOGA 1 ,Apartamenti Nr 18,Tirane zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1,000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

5.2. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te asamblese se ortakeve i cili eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

5.3. Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Ne rast se nje apo disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset qe i rezervohen atij/atyre ne rritjen e kapitalit mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

5.4. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te asamblese se ortakeve organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufirin qe percakton ligji. Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

ORGANI VENDIMMARRES

NENI 6

6.1. Organi vendimmarres i shoqerise eshte asambleja e pergjithshme e ortakeve:

6.2. Asambleja e ortakeve me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës ($\frac{3}{4}$) vendos per çeshtje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

6.3. Te gjitha vendimet e marra nga asambleja e pergjithshme duhet te regjistrohen ne librin e proces-verbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



6.4 Njoftimi duhet te permbaje : vendin, daten, oren e mbledhjes ,pjesemarresit ne mbledhje dhe rendin e dites dhe tu dergohet ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

6.5 Asambleja e Perjithshme emerone nje ose me shume persona fizik si Administrator te shoqerise Afati i emertimit eshte 5 vjet, me te drejte ripertertije. Emertimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

6.6 Ortaket themelues unanimisht vendosin te caktojne si Administrator te pare te shoqerise "**BPM**" shpk per nje afat 5 vjecar :

Z.ARTUR KURTI lindur ne Tirane, Shqipëri ne daten 04/03/1975 ,identifikuar me karte identiteti me NR: H50304061W banues ne adresen Lagjia ALI DEMI ,Rruga Zonja Curre Pallati BOGA 1 ,Apartamenti Nr 18,Tirane,i cili ushtron të gjltha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm të Shoqërise

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 7

7.1 Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, nga ortaket dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Administratori dhe ortaket jane perfaqesuesit e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe kane kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

7.2 Cdo kontrate do te kryhet prej tyre dhe ne rast mungese Shoqeria do te perfaqesohet nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

NENI 8

8.1 Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve bazuar ne kuotat qe ata zoterojne.

NENI 9

9.1 Ortaket themelues kane te drejte te emerojne dhe administrator te tjere, kane te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake, sipas kushteve dhe kritereve te percaktuara ne statut.

NENI 10

10.1 Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.



NENI 11

11.1 Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

NENI 12

12. 1 Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr. 9901 date, 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

NENI 13

13.1 Akti i Themelimit u perpilua ne 2 kopje, (dy) faqe gjithsej per t'ju shperndare organeve kompetente. Akti i Themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

"BPM "- sh.p.K

Artur Kurti



Tirane me 01.08.2022